

**VENDIM**  
**Nr.892, datë 21.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FORMALITETET E ANIJEVE QË OPEROJNË  
NË PORTET DETARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9428, datë 13.10.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për krijimin e lehtësirave për trafikun ndërkombëtar detar (Londër, më 9 prill 1965)”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për formalitetet e anijeve që operojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr.465, datë 6.10.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për bashkërendimin e veprimeve të organeve të kontrollit shtetëror dhe subjekteve që veprojnë në portet detare të Republikës së Shqipërisë””, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet e tjera shtetërore, si dhe organet që kryejnë aktivitet në portet detare për kontrollin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

---

<sup>1</sup> Direktiva 2002/6/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian e 18 shkurtit 2002 “Mbi raportimin e formaliteteve për anijet që mbërrijnë dhe/ose nisen nga portet e shteteve anëtare të Komunitetit”, me nr.CELEX 32002L0006.